



Pranuar / Dërguar Punimja/Prodato Received/Delivered	21-06-2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMB/KK	3246	2021	114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.399/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bektëshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.399/2021 të datës 07.05.2021, të parashtruar nga grup ankuesish, Rrahmani të përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, kudër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike *“kompensim material”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.399/2021 e datës 07.05.2021, e parashtruar nga grup ankuesish \_\_\_\_\_ të përfaqësuar nga \_\_\_\_\_

### A r s y e t i m

Ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ janë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë: \_\_\_\_\_ ka lidhur kontratën e marrëdhënies së punës me numër 541 të datës 01.08.2019 në vendin e punës “Zyrtare e Lartë për Integritet Evropian” në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, sipas marrëveshjes për Bursë 2016/2017, e lidhur në mes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria për Integritet Evropian dhe se kjo kontratë lidhet për periudhë tre vjeçare (3), \_\_\_\_\_ ka lidhur kontratën e marrëdhënies së punës me numër 542 të datës 01.08.2019 në vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Koordinim të Politikave” në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, sipas marrëveshjes për Bursë 2016/2017, e lidhur në mes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_



Ministria për Integritet Evropian dhe se kjo kontratë lidhet për periudhë tre vjeçare (3) dhe Gresa Rrahmani ka lidhur kontratën e marrëdhënies së punës me numër 888 të datës 05.12.2019 në vendin e punës "Zyrtare e Lartë për Integritet Evropian" në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave sipas marrëveshjes për Bursë 2016/2017, e lidhur në mes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria për Integritet Evropian dhe se kjo kontratë lidhet për periudhë tre vjeçare (3).

Ankuesit dhe me numër 207 të datës 12.03.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kërkesën për njohjen e të drejtës për kompensim shtesë në vlerë prej 250 Euro në muaj sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2021 dhe Vendimi Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pasi që ankuesit nuk marrin përgjigje lidhur me kërkesën e tyre të datës 12.03.2021 me datë 07.05.2021 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë parashtrojnë ankesën me numër të protokollit 2285/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensim material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 18.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me datë 20.05.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me provat e bashkëngjitura të lëndës 1/32.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Plotësimi i ankesës së ankuesve i datës 04.06.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesve e datës 07.05.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e ankuesve e datës 12.03.2021; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.08.2019 e Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 05.12.2019 e Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.08.2019 e Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 03/82 i datës 04.07.2012; Vendimi i Qeverisë së Kosovës me numër 08/170 i datës 14.02.2014; Vendimi i Qeverisë së Kosovës me numër 03/82 i datës 04.07.2012; Kërkesa e datës 12.03.2021; Formularët e sektorit të pagave si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve dhe është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhë tri (3) vjeçare bazuar në Marrëveshjen për Bursë në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës 2016/2017, sipas Kontratës Nr. Protokollit 541 të datës 01.08.2019, në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Integritet Evropian", ka themeluar marrëdhënie pune pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhë tri (3) vjeçare bazuar në Marrëveshjen për Bursë në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës 2016/2017, sipas





Kontratës Nr. Protokolli 542 të datës 01.08.2019, në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Zyrtarë i Lartë për Koordinim të Politikave" si dhe Gresa Rrahmani ka themeluar marrëdhënie pune pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhë tri (3) vjeçare bazuar në Marrëveshjen për Bursë në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës 2016/2017, sipas Kontratës Nr. Protokolli 889 të datës 05.12.2019, në pozitën e punës "Zyrtarë i Lartë për Integritet Evropian".

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi

dhe me datë 12.03.2021 ju kanë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me shkresa veç e veç për njohjen e të drejtës për kompensim shtesë në vlerë prej 250 Euro në muaj sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimi Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe pasi që nuk marrin përgjigje me datë 07.05.2021 parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës së datës 04.07.2012 dhe ndryshim plotësimin e datës 14.02.2014 dhe ankuesit me datë 04.06.2021 bëjnë plotësimin e ankesës së datës 07.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me ç'rast kërkojnë që ti njihet kompensimi i shtesës në mënyrë retroaktive nga momenti i nënshkrimit të kontratave për marrëdhënie tyre të punës deri në muajin majë 2021 pasi që nga ky muaj Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar ekzekutimin e pagës shtesës mujore në vlerë prej 250 Euro për të tre (3) ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesit që nga nënshkrimi i kontratave të marrëdhënies së punës me Ministrinë e Punëve të Brendshme, kanë pas të drejtë që të parashtrojnë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në organin e punësimit në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit për shërbimin civil se në kohën e nënshkrimit të marrëdhënies së punës me Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë qenë të aplikueshme ende dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe ankuesit kanë pas të drejtë që të veprojnë në pajtim me dispozitat e nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton se: *"2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"*, andaj ankesa e ankuesve e datës 07.05.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2285/2021 është e para afatshme sepse ankuesit nuk i kanë shtjerr mjetet e brendshme juridike kur kemi parasysh faktin e pretendimit ankimor të ankuesve me plotësim e ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së datës 04.06.2021 që kërkojnë kompensimin e mjeteve monetare në mënyrë retroaktive që nga data e themelimit të marrëdhënies së punës me Ministrinë e Punëve të Brendshme konkretisht nga data 01 gusht 2019 për dhe ndërsa për nga data 04.12.2019.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.399/2021, datë 21/06/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

*Përfaqësuesit të grupit të ankuesve  
Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;  
Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe  
Arkivit të KPMSHCK- së.*

